



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR-DHJETOR 2023

Ligji 119/2014

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	18.01.2023	Kërkohej informacion në lidhje me organizatat OJF që kanë operuar në Bashkinë Klos.	24.01.2023	Në Bashkinë e Klosit gjatë vitit 2022 nuk ka operuar asnjë organizatë jofitimprurëse (OJF) dhe si rrjedhojë nuk ka pasur asnjë mbështetje financiare nga buxheti i bashkisë dhe as bashkëpunime.	-Me email	Nuk ka
2	10.02.2023	Kërkohej informacion i përgjithshëm në lidhje me parapërgaditjen për zgjedhjet e 14 Majit.	27.02.2023	Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka elokuar fondin në funksion të procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve, dhe si rrjedhojë ky proces ende nuk ka nisur. Listat emërore për zgjedhjet e 14 Majit janë afishur për njohje në institucione të ndryshme në Bashkinë Klos. Në këtë proces janë angazhuar administratorët e 4 (katër) Njësive Administrative në Bashkinë e Klosit dhe kryetarët e fshatrave të cilët kanë si funksion njoftimin dhe drejtimin e qytetarëve në qendrat e tyre të votimit.	-Me postë zyrtare	Nuk ka

3	23.02.2023	<p>Prefekti i Qarkut Dibër kërkon informacion në lidhje me ankesën e shtetasit Ramiz Lela për dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.</p>	27.02.2023	<p>Verifikimi në banesën e shtetasit Ramiz Lela është bërë më datë 18.05.2021 nga grupi i punës dhe sipas procesverbalit të mbajtur po në këtë datë, banesa në fjalë ka dëmtime të rënda të ardhura si pasojë e rrëshqitjes masive të një sipërfaqe toke, 3 dynym bashkë me truallin e shtëpisë, shkaktuar nga reshjet e dendura të shiut 22-26 janar 2021.</p> <p>Pas konstatimit të situatës, Komisioni i Vlerësimit e ka vlerësuar dëmtimin e objektit, shkaktuar nga rrëshqitja masive e tokës, me vlerën 2,147,019 lekë dhe banesa është shpallur e pabanueshme.</p> <p>Sektori i Emergjencave Civile pasi ka mbledhur të gjithë dokumentat e nevojshme për trajtimin e këtij rasti emergjent, ka dërguar dosjen e plotë në Prefekturën e Qarkut Dibër për miratimin e saj.</p> <p>Nga Prefektura është kërkuar të vihet në dispozicion “Leja e Ndërtimit” nga ana e Z. Ramiz Lela, dokument i cili dhe pse është kërkuar disa herë nga ana jonë, nuk është vënë në dispozicion duke penguar kështu edhe mbylljen e këtij procesi.</p>	Me postë zyrtare	Nuk ka
				<p>Lidhur me problematikën e mbetjeve në zonën “Qafë Dushk” në Njësinë Administrative Klos ju bëjmë me dije se Bashkia Klos ka ndërmarrë aksione konkrete, çdo të premte të fundit të muajit, ku është pastruar zona periodikisht dhe vullnetarisht nga administrata e bashkisë.</p>		

4	02.03.2023	Avokati i Popullit kërkon informacione në lidhje me mbetjet e hedhura në zonën e Qafë Dushkut	15.03.2023	Siç edhe ju e parashtroni në kërkesën tuaj, si institucion nuk kemi informacione dhe të dhëna mbi individët apo subjektet tregtare që hedhin mbetjet në këtë zonë. Problematika në këtë zonë nuk paraqitet serioze pasi aksionet e vazhdueshme nga ana jonë kanë bërë të mundur pastrimin periodik të zonës në fjalë. Me urdhër të kryetarit, nr.49, datë më 27.02.2023, është ngritur komisioni për “Hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve” ku do të merren parasysh të gjithë zonat problematike për mbetjet në territorin e Bashkisë Klos për t’ju gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë.	-Me postë zyrtare	Nuk ka
5	15.04.2023	Gazetari Dritan Kurti kërkon informacion në lidhje me mjetet motorike në pronësi të Bashkisë Klos.	25.04.2023	Gazetarit Dritan Kurti i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar.	Me email	Nuk ka
6	13.04.2023	Shoqata kombetare "Shpresë për të verbërit" kërkon informacion mbi listën e personave me statusin e të verbëreve në Bashkinë Klos.	08.05.2023	Informacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion shoqatës "Shpresa për të verbërit".	Me postë zyrtare	Nuk ka

7	05.05.2023	Shoqata "Kongresi Rinor Kombëtar" kërkon informacion mbi Këshillin Vendor të Rinisë në Bashkinë Klos.	11.05.2023	<p>Në Bashkinë Klos është ngritur Këshilli Vendor i Rinisë i cili ka zhvilluar mbledhje periodike që nga organizimi i tij, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Adelina Laçi Kryetar 2. Eni Marsela Anëtar 3. Skejdi Lami Anëtar 4. Aleksandra Gjonaj Anëtar 5. Fjorent Nikollaj Anëtar 6. Armela Dishit Anëtar <p>Bashkia Klos është e angazhuar në realizimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029, duke planifikuar aktivitete të ndryshme si dhe implementimin e projektit të qendrës multifunksionale për rininë.</p>	Me email	Nuk ka
8	18.05.2023	Znj. Diana Hila kërkon informacion në lidhje shërbimit veterinar në Bashkinë Klos.	29.05.2023	<p>Në strukturën e Bashkisë Klos kemi pozicionin "Specialist Veterinar" në varësi të Sektorit të Këshillimit të Shërbimeve Bujqësore, Kontrollit Ushqimor dhe Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Pyjeve. Në institucionin tonë kemi një Specialist Të Shërbimit Veterinar, Znj. Denisa Dani. Në Bashkinë Klos nuk ka fonde të përcaktuara në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit si dhe nuk është hartuar program pune për profilaksinë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve endacake.</p>	Me email	Nuk ka

9	12.06.2023	Komisioneri për të drejtën e informimit/ Dritan Kurti	14.06.2023	Dokumentat e kërkuara janë vënë në dispozicion të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe gazetarit Dritan Kurti.	Me postë zyrtare Me email	
10	22.06.2023	Znj. Aurora Shpataj kërkon informacion mbi arsimin në Bashkinë Klos.	03.07.2023	Në Bashkinë Klos janë ekzistuese 24 shkolla, 32 gjithsej së bashku me anekset. Në përgjigje të pikës 2, ju bëjmë me dije se gjatë vitit shkollor 2021-2022 janë regjistruar 1357 nxënës në 9-vjeçare, 150 prej tyre në klasën e parë. Gjatë viteve 2022-2023 në 9-vjeçare kanë marrë mësim 1280 nxënës, 143 nxënës prej tyre në klasën e parë. Numri i nxënësve në gjimnaz gjatë periudhës kohore 2021-2022 ka qënë 372, të regjistruar në vitin e parë 113. Në përgjigje të pikës 5, gjatë vitit shkollor 2023-2023 në gjimnaz kanë marrë mësim 337 nxënës, 113 nxënës të regjistruar për herë të parë. Gjatë viteve 2021-2023 janë mbyllur 3 anekse, Klos Katundi, Petralba, Lezaj/ Xibër.	Me email	Nuk ka

	<p>11 04.07.2023</p>	<p>BIRN kërkon informacion mbi punësimet në Bashkinë Klos për periudhën maj 2022-maj 2023</p>	<p>17.07.2023</p>	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të ardhur përmes email më datë 04.07.2023 regjistruar në regjistrin elektronik të kërkesave për informacion me Nr. 11, në lidhje me punësimet në Bashkinë Klos gjatë periudhës maj 2022-maj 2022, përgjigja vijon si më poshtë:</p> <p>Gjatë periudhës 31 maj 2022- 31 maj 2023 në institucionin tonë janë kryer 27 punësime, 17 me kontratë të përhershme, 10 me kontratë të përkohshme.</p>	<p>Me postë zyrtare Me email</p>	<p>Nuk ka</p>
--	-----------------------------	---	--------------------------	--	---	--------------------------

	<p>12 05.07.2023</p>	<p>KRIIK kërkon informacion mbi situatën pas zgjedhore në Bashkinë Klos</p>	<p>12.07.2023</p>	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion me Nr.2307/174 B prot., datë 02.07.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2009 prot, datë 05.07.2023, përgjigjja vijon si më poshtë.</p> <p>Bashkia Klos nuk ka pasur asnjë komunikim shkresor me ndonjë nga monitoruesit e fushatës zgjedhore të kontraktuara nga KQZ në funksion të zgjedhjeve. Gjatë fushatës zgjedhore janë vendosur materiale propagandistike në vende publike të cilat janë hequr menjëherë pas zgjedhjeve të 14 majit 2023, ndërsa përsa i përket reklamave në vende të ndriçuara, në Bashkinë Klos nuk ka.</p> <p>Në Bashkinë Klos janë të hapura 2 zyra zgjedhore, të dyja në qendër të qytetit të Klosit nga subjektet zgjedhore; “Partia Socialiste” dhe “Koalicioni Bashkë Fitojmë”.</p>	<p>Me email</p>	<p>Nuk ka</p>
--	-----------------------------	---	--------------------------	--	------------------------	----------------------

13	06.07.2023	KRIIK kërkon informacion në lidhje me sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore	20.07.2023	<p>Në Bashkinë Klos është miratuar "Urdhëri" për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civile gjatë procesit zgjedhor. Bashkëngjitur shkresës gjendet kopja e "Urdhërit" nr.24, datë 17.02.2023, "Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor".</p> <p>Në përgjigje të pikës 3, në institucionin tonë është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Grupit të Monitorimit në lidhje me mbikqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore.</p> <p>Me miratimin e rregullores, ajo u është shpërndarë të gjithë nëpunësve në Bashkinë Klos për t'u njohur me të. Në përgjigje të pikës 6 ju bëjmë me dije se brenda afateve të parashtruara është informuar Komisioneri për Mbikëqyerjen e Shërbimit Civil duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.</p> <p>Grupi i monitorimit ka komunikuar periodikisht nëpërmjet koordinatorit të emëruar me personin e kontaktit të ngritur nga KMSHC, duke marrë në kohë reale orientimet e këtij institucioni. Theksojmë se ky komunikim ka qënë efikas dhe nuk janë hasur problematika gjatë procesit.</p>	Me email	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	----------	--------

14	07.07.2023	Znj. Era Sherifaj kërkon informacion mbi të rinjtë në Bashkinë Klos		<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të ardhur përmes email, datë 07/07/2023, regjistruar në Regjistrin e Kërkesave për Informacion me nr rëndor 14, përgjigjja vijon si më poshtë.</p> <p>Në Bashkinë Klos, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është parashikuar buxhet vjetor, dhe zë 0,3 % të buxhetit. Në strukturën e Bashkisë Klos, kemi të punësuar 39 shtetas të moshës nga 18-29 vjeç, ku 28 prej tyre janë të gjinisë femërore, 11 prej tyre janë të gjinisë mashkullore.</p> <p>Në përqindje, punësimet e kësaj moshe në krahasim me strukturën e plotë zë 17,64 %. Në institucionin tonë kemi “Sektorin e Turizmit, Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Rinisë” i cili është përgjegjës mbi politikat rinore, aktivitete të ndryshme në lidhje me të rinjtë. Në Bashkinë Klos kemi të ngritur Këshillin Vendor të Rinisë i cili ka zhvilluar mbledhje periodike që nga organizimi i tij.</p>	Me email	Nuk ka
15	27.07.2023	Res Publika kërkon informacion mbi NE në Bashkinë Klos	31.07.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të ardhur përmes email më datë 27.07.2023 regjistruar në regjistrin elektronik të kërkesave për informacion me Nr. 15, në lidhje me Ndhmën Ekonomike dhe fondin 6 % në Bashkinë Klos, përgjigjja vijon si më poshtë.</p> <p>Në Bashkinë Klos trajtohen me Ndhmë Ekonomike 1529 familje/individë. 93 familje/individë janë përfshirë në fondin 6 % në të katërta Njësitë Administrative të Bashkisë Klos.</p>		Nuk ka

16	02.08.2023	Znj. Jona Gazheli kërkon informacion mbi qendrat rinore në Bashkinë Klos	02.08.2023	Në përgjigje të shkresës tuaj të ardhur përmes email më datë 02.08.2023 në lidhje me qendrat rinore në Bashkinë Klos, përgjigja vijon si më poshtë: Në territorin e Bashkisë Klos nuk ka asnjë qendër rinore. Aktualisht është në zbatim një projekt I fituar nga BE për të hapur një qendër rinore multifunkionale e cila do të jetë nën administrimin e Bashkisë Klos.	Me email	Nuk ka
17	10.08.2023	Z.Julian Hoxhaj kërkon informacion mbi arsimin parashkollor në Bashkinë Klos	10.08.2023	Në përgjigje të shkresës suaj më datë 10.08.2023, ardhur përmes email regjistruar në regjistrin e Kërkesave për Informacion me nr. 17, në lidhje me arsimin parashkollor në Bashkinë Klos, përgjigja vijon si më poshtë. Në Bashkinë Klos janë të hapur dhe funksional 23 (njëzet e tre) kopshte në të katërta njësitë administrative dhe 0 (zero) çerdhe. Nga 23 (njëzet e tre) kopshte, 1 (një) prej tyre funksionon me ushqim. Duke qënë se Bashkia Klos momentalisht nuk ka asnjë çerdhe në territorin e saj si rrjedhojë nuk kemi numër fëmijësh përfitues nga ushqimi dhe tarifë mbi këtë shërbim.	Me email	Nuk ka

	<p>18 28.12.2023</p>	<p>Res Publika kërkon informacion mbi konsumin e energjisë elektrike në godinat e Bashkisë Klos</p>	<p>10.01.2024</p>	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion në lidhje me konsumin e energjisë elektrike në godinat e Bashkisë Klos për periudhën 01.10.2021 – 20.10.2023, përgjigja vijon si më poshtë:</p> <p>Bashkia Klos ka dy godina funksionale nga ku qytetarët e zonës marrin shërbime dhe përgjatë periudhës në fjalë konsumi i energjisë elektrike sipas viteve është:</p> <p>Përgjatë vitit kalendarik, 2021, janë shpenzuar nga buxheti për energjinë elektrike 351 116 Lekë. Përgjatë vitit kalendarik, 2022, janë shpenzuar nga buxheti për energjinë elektrike 744 480 Lekë. Përgjatë vitit kalendarik, 2023, janë shpenzuar nga buxheti për energjinë elektrike 566 700 Lekë.</p> <p>Si rrjedhojë, përgjatë periudhës 01.10.2021- 20.10.2023 në institucionet e Bashkisë Klos janë shpenzuar për energjinë elektrike 1662 296 lekë.</p>	<p>Me email</p>	<p>Nuk ka</p>
--	-----------------------------	---	--------------------------	--	------------------------	----------------------